



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700887/6

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandohet plotësimi i nevojave materiale për të ofruar shërbimin stomatologjik në IEVP në Rrugën "Ali Demi", Tiranë*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**
Z. Arben ÇUKO

TIRANË

I nderuar Z. Çuko,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i burgosuri S. K., i cili pretendon se në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB) nuk po i ofrohet shërbim stomatologjik. Sipas shpjegimit të ankuesit, ai ka kërkuar të mbushi një dhëmballë por, dentisti i institucionit i është përgjigjur se mungon materiali mbushës.

Në përfundim të hetimit të këtij rasti rezultoi se, shërbimi stomatologjik për të burgosurit me masë mjekësore "mjekim i detyruar" të hospitalizuar në IVSHB mbulohet nga mjeku stomatolog i IEVP në Rrugën "Ali Demi", Tiranë. Aktualisht ankuesi nuk mund të marrë shërbim në klinikën stomatologjike të IEVP-së pasi mungon baza materiale dhe nuk funksionon poltroni dental.

Referuar legjislacionit në fuqi, shërbimi shëndetësor për të burgosurit sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në IEVP. Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve. Shërbimi dentarë për të paraburgosurit dhe të dënuarit kryhet në klinikën dentare të IEVP-së (neni 33 i Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" dhe nenet 102-105 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve).

Sigurimi i materialeve dhe pajisjeve për të ofruar shërbimin stomatologjik në IEVP në Rrugën "Ali Demi" do të mundësonte trajtimin mjekësor jo vetëm të ankuesit S. K. por, edhe të të burgosurve të tjerë, kërkesat e të cilëve mbulohen nga ky institucion.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në

mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

JU REKOMANDOJMË:

- Sigurimin e materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për të ofruar shërbim stomatologjik në IEVP në Rrugën "Ali Demi", Tiranë;
- Mjekimin në klinikën stomatologjike të IEVP-ve të tjera të të burgosurve që nuk kanë mundësi financiare për tu mjekuar në klinika private dhe që nuk mund ti ofrohet ky shërbim në IEVP në Rrugën "Ali Demi", Tiranë.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI